

**N.T.SH Elen**



**Kolegji ESLG**

## MEMORANDUM PËR BASHKPUNIM DHE NJOHJE TË NDËRSJELLTË

NDËRMJET

Kolegjit "ESLG"- Prishtinë

dhe

N.T.SH Elen

### I. Qëllimi i Memorandumit

1. Me këtë memorandum palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar arritjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të infrastrukturës së energjisë, eficiencës së energjisë dhe menaxhimit efikas të energjisë në sektorin ndërtimor dhe me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të njohurive profesionale të studentëve dhe profesorëve dhe duke synuar ndërlidhjen e mësimit akademik në ESLG me punën praktike;

### II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. N.T.SH Elen zotohet se do të ofrojë këshillat e saj për përpilimin e planprogrameve moderne të lëndëve përkatëse në programin Menaxhimi i Energjisë niveli bachelor;
2. N.T.SH Elen zotohet se do të ofrojë praktikën për studentët e programit Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) dhe Menaxhimi i Energjisë (BA);
3. Kolegji ESLG zotohet se do të udhëzojë studentët që të kryejnë praktikën obligative në kuadër të N.T.SH Elen;

4. Stafit akademik i Kolegjit ESLG ofron ndihmën këshilldhënëse për N.T.SH Elen dhe gjithashtu do të bashkëpunojnë në hulumtime dhe analiza të përbashkëta të cilat janë në favor të sektorit privat;
5. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve rreth standardeve dhe praktikave më të mira në fushën e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të vlerësimit të paluajtshmërive;
6. Qasje në projekte të ndërsjellta, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "ESLG" dhe N.T.SH Elen;
7. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse ndërmjet palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

### III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

### IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Ky Memorandum hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit;
3. Ky Memorandum është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 16.04.2016

### PALËT NËNSHKRUESE

N.T.SH Elen


Kolegji "ESLG"

Partner Menaxhues

Kryetari Bordit

Lulzim Kyla

Dr. Visar Hoxha



Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Kolegjit ESLG dhe N.T.SH Elen